

Kosova mundet ma mirë!

Bedri Hamza
për Kryeministër.

PDK



FJALË HYRËSE

Jeta e qytetarëve ka mundur të jetë më e mirë në këto katër vjetët e fundit. Ka mundur të jetë shumë më mirë edhe Kosova. Jemi pajtuar me të gjithë juve për këtë! Unë me qytetarët, me plane të matshme e konkrete për qytetarët dhe Kosovën, e kemi bërë programin tonë. Është fryt i shumë punëtorëve që i kam zhvilluar në Kosovë e diasporë. Është reflektim i asaj që më keni kërkuar e jam konsultuar me ndërmarrës, mësimdhënës dhe ekspertë të shumtë. Është tërësisht i realizueshëm dhe do të zbatohet në qeverisjen time nga ministra kompetentë, të cilët i kuptojnë nevojat e qytetarëve dhe kanë ekspertizën e duhur për fushat që do t'i mbulojnë. Është program që krijon mundësi dhe kushte që çdo qytetar, çdo profesionist, çdo punëtor ta realizojë veten në profesionin dhe punën e tij, jo diku tjetër, por në Kosovë.

Në vendet me ekonomi jo aq të zhvilluar, me papunësi të theksuar, programi më i rëndësishëm i mirëqenies sociale për çdo qytetar është një punë e mirë me pagë të dinjitetshme. Paga të dinjitetshme do të ketë për të gjithë. Jam i dëshmuar për këtë. Ekzistojnë strategji të mirëfillta për t'i rritur të ardhurat, duke e ruajtur stabilitetin fiskal. Ekzistojnë zgjidhje ku të gjithë mund të fitojnë. I kam parë mangësitë e qeverisë aktuale. I kam parë edhe mundësitë e humbura. Besimin tuaj e kërkoj, sepse jam i bindur që alternativa që ofroj është më e mira për ju!

Sa ju është përmirësuar jeta në këto katër vjet? Sa është shtrenjtuar shporta e juaj si konsumatorë? A po i rrisni fëmijët tuaj më lehtë dhe a po arsimohen ata më mirë? Kujdesi ndaj të moshuarve a është përmirësuar?

Po shërbimet shëndetësore? Këto janë preokupime të përditshme të të gjithë qytetarëve tanë. Unë ofroj zgjidhje për to!

Ne nuk mund të rrimë duarkryq teksa mijëra të rinj, vajza e djem, largohen çdo vit, pasi nuk shohin këtu të ardhme. Nuk mund të heshtim teksa Kosova izolohet gjithnjë e më shumë. Nuk mund as të qëndrojmë indiferentë kur partnerët ndërkombëtarë, që na përkrahën me dekada, sot janë të zhgënjyer nga mungesa e progresit dhe bashkëpunimit. Është e rëndë teksa shohim shumë kompani që mbyllen për shkak të mungesës së inxhinierëve dhe operatorëve të makinerisë prodhuese, sepse ata po ikin në kërkim të mundësive më të mira në vende të huaja.

Ekonomia jonë po përballet me kriza të njëpasnjëshme. Qytetarët janë lënë të vetëm në betejën e përbaljes me kostot e jetesës. E sfidat e tyre nuk janë thjesht numra të raporteve. Ato janë jetë njerëzish. Janë prindër që nuk mund t'ua sigurojnë fëmijëve të ardhmen që meritojnë. Janë të rinj të talentuar që po e braktisin vendin me zemër të thyer.

Kjo gjendje duhet të ndryshojë. Ne duhet të bëhemi bashkë që ta ndryshojmë.

Në këtë udhëkryq për Kosovën, ne po qëndrojmë përballë një zgjedhjeje vendimtare: ta pranojmë gjendjen në të cilën jemi apo të bashkohemi që të punojmë për një Kosovë më të mirë? Unë kam zgjedhur të dytën kur e kam pranuar nominimin për Kryeministër. Programi im nuk është thjesht një premtim për të nesërmen. Është një thirrje për veprim. Është një kampanë që fton çdo qytetar të Kosovës të besojë në forcën e tij, në mundësitë që vendi ynë ofron. Është ftesë për t'u bashkuar që ta bëjmë Kosovën më të mirë.

Lexoni programin tim! Analizojeni! Nëse e gjeni veten në të dhe dëshironi që të jetësohet, bashkohuni me mua! Kosova duhet të ecë përpara dhe e diela e 9 shkurtit 2025 është një shans që nuk guxojmë ta humbim! Për të mirën e Kosovës, për të mirën e fëmijëve, grave dhe burrave, të rinjve dhe të moshuarve, ju ftoj të bëhemi bashkë për një Kosovë më të mirë! Të gjithë, pa dallim!

Me respekt,
Bedri Hamza
Kandidat për Kryeministër

VIZIONI

Kosova, shtet i bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat, me një rol mbështetës dhe lehtësues të qeverisë, e aftë për të siguruar të ardhura dhe mirëqenie të lartë për të gjithë qytetarët, ku të rinjtë e gjejnë perspektivën për t'u zhvilluar, ku nevojtarët e gjejnë mbështetjen e duhur nga shteti, ku shteti është i aftë të ofrojë siguri dhe kushte për të gjithë ata që kërkojnë një jetë të lumtur dhe prosperuese.

Plani jonë, "Kosova mundet ma mirë", paraqet një agjendë transformuese e cila mundëson adresimin e sfidave dhe nevojave kryesore që i ka vendi për të siguruar një jetë më të mirë për të gjithë qytetarët.

Plani jonë zhvillimor ndërtohet rreth këtyre pesë qëllimeve kyçe:

1. ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK

2. JETË MË E MIRË PËR SECILIN

3. ARSIM PËR TË ARDHMEN

4. SISTEM SHËNDETËSOR ME PACIENTIN NË QENDËR

5. NJË KOSOVË E SIGURT DHE E INTEGRUAR

Secili prej këtyre qëllimeve shtjellohet në shtylla specifike, të cilët bashkërisht vënë themelet për një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës.



Qëllimi 1

Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik



PDK

Transformimi i vendit përmes investimeve strategjike në infrastrukturë, nxitjes së kapitalit privat, krijimit të vendeve të reja të punës dhe sigurimit të stabilitetit energjetik. Synimi ynë është një zhvillim gjithëpërfshirës që fuqizon çdo rajon dhe rrit cilësinë e jetesës për qytetarët, duke krijuar një ekonomi të qëndrueshme për brezat e ardhshëm. Përmes këtij angazhimi të fuqishëm, synojmë të rrisim mundësitë ekonomike për të gjithë qytetarët, duke ofruar shanse reale për një të ardhme më të mirë dhe të sigurt në vendin e tyre.



Shtylla 1: Investime Transformuese në Infrastrukturën Publike

Investimet transformuese në infrastrukturë janë kyçe për rritjen e Kosovës. Infrastruktura publike, e gatshme për të ardhmen, do të shërbejë si shtyllë kurrizore e progresit ekonomik, duke mundësuar zhvillim për individët dhe bizneset. Kjo shtyllë fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës fizike të vendit, përfshirë transportin, energjinë dhe ujin.

Zotimi 1: TRANSFORMIMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE DHE HEKURUDHORE TË KOSOVËS

■ Për të përmirësuar lidhshmërinë, rritjen ekonomike dhe integrimin rajonal, ne zotohemi për zbatimin e projekteve kyçe të infrastrukturës që do të transformojnë rrjetin e transportit të Kosovës. Projektet prioritare përfshijnë:

1. Investimi në ndërtimin dhe modernizimin e linjës hekurudhore ndërmjet Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", përfshirë zgjerimin nga fshati Vrellë deri në aeroport dhe elektrifikimin e linjës hekurudhore.
2. Përfundimi i autostradës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë.
3. Lidhja e dy autostradave përmes ndërtimit të segmentit Qafë Duhël – Shtime – Lipjan – Banullë.
4. Ndërtimi i unazës së jashtme të Prishtinës.
5. Përfundimi i modernizimit të linjës hekurudhore 10 (148 km nga Leshaku në Han të Elezit), duke e integruar Kosovën në rrjetin hekurudhor ndërkombëtar.

6. Ndërtimi i një lidhjeje hekurudhore me Shqipërinë.

7. Funksionalizimi i linjës hekurudhore Klinë - Prizren dhe elektrifikimi i rrjetit hekurudhor për të arritur një shpejtësi të shërbimit prej 120 km/h.

Zotimi 2: NDËRTIMI I DIGAVE SHITESË/ LIQENEVE AKUMULUESE

■ Ndërtimi i gjashtë digave shtesë për të garantuar sigurinë e ujit për bujqësinë, industrinë dhe familjet. Këto projekte do të përfshijnë ndërtimin e liqeneve akumuluese në Firajë, Shtimje, Kuqicë të Skenderajt, Verboç të Drenasit, si dhe Kremenatë, Desivojnë dhe Shipashnicë të Kamenicës.

Zotimi 3: INVESTIME NË INFRASTRUKTURËN PUBLIKE PËR QENDRAT E SKIJIMIT

■ Zhvillimi dhe zbatimi i një plani gjithëpërfshirës të investimeve në infrastrukturën publike në Brezovicë dhe Borea, përfshirë rrugët, skiliftet dhe shërbimet thelbësore. Kjo do të krijojë një mjedis të favorshëm për tërheqjen e investimeve të sektorit privat në këto dy resorte skijimi, duke promovuar kështu Kosovën si destinacion kryesor të skijimit në rajon.



Shtylla 2: Mbështetje e fuqishme për biznesin dhe mjedisin e favorshëm afarist

Reformat fiskale dhe një ambient i favorshëm afarist do të jenë shtyllat kryesore bartëse të rritjes ekonomike në Kosovë, duke mundësuar rritjen e investimeve, krijimin e vendeve të punës dhe përparimin teknologjik.

Zotimi 1: STIMUJT FISKAL PËR RITJEN E BIZNESIT DHE MBËSHTETJEN E QYTETARËVE

■ Ndryshimi i praktikës së pagesës së TVSH-së për mallrat e importuara, duke e transferuar mbledhjen e TVSH-së në brendi të Kosovës, në mënyrë që bizneset të paguajnë TVSH-në pas shitjes së produkteve dhe jo në kufi, duke lehtësuar kështu barrën e tyre financiare.

■ Përjashtimi nga tatimi për bizneset e vogla me qarkullim deri në 10,000 € (përveç shërbimeve profesionale si avokatia dhe konsulenca).

■ Bizneset me qarkullim ndërmjet 10,000 € dhe 30,000 € do të taten bazuar në fitimin real, jo me normën 9%.

■ Lirimi nga tatimi në fitim, për periudha të caktuara kohore, për bizneset që investojnë mbi 500 mijë euro apo që punësojnë mbi 50 punëtorë.

■ Eliminimi i tarifës doganore për importin e veturave të reja elektrike.

■ Zvogëlimi i barrës tatimore në të ardhurat personale, duke ripërkallëzuar normat e tatimit si vijon: pagat deri në 400€ nuk do të taten, pagat 400€ - 800€ taten me 8%, dhe mbi 800€ taten me 10%.

- Shfuqizimi i ligjit aktual për tatimin në pronë, për të siguruar barrë të përballeshme tatimore për familjet dhe bizneset.

Zotimi 2: FINANCIM PËR MBËSHTETJE TË INVESTIMEVE PRIVATE

- Programi i fuqishëm qeveritar për mbështetjen financiare të sektorit privat, që ofron subvencione dhe grante deri në 30% të shumës totale të investimit.
- Zgjerimi i rolit të Fondit të Garantimit të Kredive të Kosovës (FGKK), duke i mundësuar lejimin e linjave kreditore me destinim të caktuar për institucionet financiare që veprojnë në Kosovë, për të siguruar kredi me kushte më të favorshme për bizneset në sektorët strategjikë të vendit.
- Themelimi i Bursës së Kosovës, e cila do të shërbejë si platformë e tregut të kapitalit për sektorin privat, ku kompanitë kosovare do të mund të tregtojnë aksione dhe letra me vlerë, duke krijuar një kanal të ri për mbledhjen e fondeve nga investitorët, si dhe duke rritur konkurrencën në sistemin financiar për të ulur kostot e financimit.

Zotimi 3: MBËSHTETJE E POSAÇME PËR NXITJEN E EKSPORTIT

- Produkte të posaçme të garantimit kreditor për kompanitë eksportuese.
- Grante për modernizim të teknologjisë dhe rritje të konkurrueshmërisë.
- Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve njerëzore të domosdoshme për rritjen e eksportit.
- Përforcimi i diplomacisë ekonomike,

duke shfrytëzuar praninë tonë diplomatike jashtë vendit dhe odat tona të biznesit.

Zotimi 4: FORMALIZIMI I NDËRTIMEVE DHE ZHBLLOKIMI I MILIARDA EUROVE KAPITAL

- Amendamenti i ligjit ekzistues për legalizimin e ndërtimeve, aty ku nuk preken pronat publike apo interesi publik.
- Krijimi i Agjencisë së Trajtimit të Ndërtesave pa Leje, e cila do të funksionojë si një “one-stop-shop,” duke bashkërenduar të gjitha institucionet e përfshira.
- Sistemi elektronik për lejet e ndërtimit, për të parandaluar informalitetin në të ardhmen dhe për të automatizuar gjithë procesin e dhënies së lejeve, duke minimizuar burokracinë dhe kontaktin e drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe zyrtarëve.

Zotimi 5: EFIKASITETI RREGULLATOR PËR MË PAK NGARKESA BUROKRATIKE PËR BIZNESET

- Krijimi i një kornize rregullative që riorganizon licencimin e biznesit, zvogëlon burokracinë dhe përmirëson lehtësinë e të bërit biznes në Kosovë.

Zotimi 6: QASJE NË FUQI PUNËTORE TË KUALIFIKUAR DHE PRODUKTIVE

- Subvencione për trajnime ndërkombëtare për profilet deficitare të punonjësve në tregun e punës.
- Mbështetje për zhvillimin e shkollave private profesionale, ku të rinjtë do të mund të ndjekin shkollim në fusha me kërkesë të lartë, si programimi,

inteligjenca artificiale, instalimet elektrike dhe shërbimet teknike.

■ Qendra trajnimi dhe inkubatorë inovacioni që do të fokusohen në aftësimin e të rinjve për të përdorur teknologji të reja si inteligjenca artificiale, robotika dhe aplikimet digjitale në prodhim.

Zotimi 7: NDËRMARRJET PUBLIKE, NGA BARRË NË INSTRUMENT ZHVILLIMI

■ Ndërmarrjet publike me potencial për zhvillim do të përfshihen në Programet për Përmirësimin e Performancës Financiare dhe Operacionale.

■ Përfshirje e kapitalit privat në ndërmarrjet publike përmes kuotimit në Bursën e Kosovës.

Zotimi 8: HAPJA E SEKTORIT MINERAR PËR INVESTIME PRIVATE

■ Trepça dhe KEK-u do të profilizohen në përpunimin e mineraleve, prodhimin e metaleve (Trepça) dhe prodhimin e energjisë elektrike (KEK-u). Ndërkohë, procesi i nxjerrjes së lëndës së parë minerale do të shkëputet nga këto dy kompani dhe do të ofrohet për investitorë përmes koncesioneve. Kjo qasje krijon mundësi për të thithur investime më të shpejta dhe të bollshme, duke shtuar të ardhurat për vendin dhe duke hapur vende të reja pune.



Shtylla 3: Vende të mira të punës dhe siguri për punëtorët

Vizioni ynë për Kosovën është një treg pune i fuqishëm dhe gjithëpërfshirës, ku çdo qytetar ka mundësinë për punë të denjë me pagë të drejtë, siguri në punësim dhe respekt për të drejtat e punës. Me reforma që forcojnë barazinë dhe cilësinë e punës, do të investojmë në programe shkollimi dhe aftësimi që u përgjigjen kërkesave të tregut dhe do të ofrojmë mbështetje për punonjësit që humbasin vendet e tyre të punës.

Zotimi 1: FONDI I PUNËSIMIT DHE PROGRAMI I SHKATHËSIVE

■ Krijimi i një fondi për të subvencionuar vendet e punës në sektorë me potencial të lartë dhe krijimi i programeve të rikualifikimit për të nxitur punësimin.

Zotimi 2: LEHTËSIMI I PAPUNËSISË DHE RIKUALIFIKIMI

■ Krijimi i Fondit të Papunësisë që ofron përfitime të papunësisë për një periudhë të caktuar, duke ndihmuar individët të përballojnë nevojat e përditshme të jetesës në rast humbjeje të punës. Fondi do të ofrojë edhe mundësi për zhvillim të shkathtësive për të papunët, për t'iu lehtësuar rikthimin në tregun e punës.

Zotimi 3: SKEMA “DIL PREJ SOCIALIT”

■ Program për përfituesit e ndihmave sociale për të inkurajuar dhe mbështetur integrimin e tyre në tregun e punës, përmes ofrimit të trajnimeve, mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit, si dhe subvencioneve të punësimin.

Shtylla 4: Siguria Energjetike

Synojmë të arrijmë pavarësinë energjetike dhe qëndrueshmërinë mjedisore përmes rritjes së prodhimit, ngritjes së kapaciteteve në energji të ripërtëritshme dhe përmirësimit të efikasitetit në shfrytëzim të energjisë elektrike. Iniciativat tona do të përfshijnë termocentrale të reja, zgjerimin e burimeve të ripërtëritshme dhe stimuj për kursim energjie, duke siguruar energji të qëndrueshme për të gjithë me kosto të përballueshme.

Zotimi 1: ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË ENERGJISË SË BAZUAR NË GAZ DHE ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME

- Investimi në infrastrukturën e re të energjisë me bazë gazi duke mbështetur njëkohësisht projektet e energjisë së ripërtëritshme, si era dhe dielli.

Zotimi 2: NISMA E KOSOVËS PËR GAZIFIKIMIN

- Ndërtimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit në shtatë qytetet e mëdha të Kosovës me synimin që të reduktohet kostoja e energjisë për familjet dhe bizneset.

Zotimi 3: AGJENCIA ME NJË NDALESË (ONE-STOP-SHOP) PËR ENERGJINË E RIPËRTËRITSHME

- Krijimi i një agjencie për të përmirësuar procesin e marrjes së lejeve për projektet e energjisë së ripërtëritshme. Investitorët në energji të ripërtëritshme do të përfitojnë nga një proces i thjeshtuar dhe i shpejtë i lejeve, duke nxitur investimet në energjinë e pastër.

Zotimi 4: EFIÇENCA E ENERGJISË DHE SUBVENCIONET E GJELBRA

- Ofrimi i subvencioneve për familjet që investojnë në panele solare, materiale izoluese dhe teknologji të tjera të gjelbra.

- Zbatimi i programeve ambicioze të efikasitetit të energjisë së bashku me sektorin privat, me synim rinovimin e ndërtesave publike

Zotimi 5: SISTEMET E NGROHJES QENDRORE NË PESË QYTETE TË MËDHA

- Realizimi i projekteve të ngrohjes qendrore në Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë, dhe Mitrovicë për të zvogëluar konsumin e energjisë. Qytetarët në këto qytete do të përfitojnë nga zgjidhjet më të lira dhe më të besueshme të ngrohjes.



Shtylla 5: Zhvillimi i Qëndrueshëm Rajonal

Do të promovojmë zhvillimin e balancuar rajonal duke ringjallur qytetet e vogla dhe duke mbështetur investimet lokale. Duke zhvilluar programe të përshtatura për secilin rajon, Kosova do të adresojë mundësitë që secili rajon ofron për zhvillim.

Zotimi 1: FONDI PËR ZHVILLIMIN RAJONAL

- Do të mbështesim projekte turistike dhe do të mbrojmë aktivitetet artizanale që karakterizojnë këto zona, duke theksuar veçantitë lokale dhe duke i bërë më tërheqëse për vizitorë.
- Do të ofrojmë mbështetje të veçantë për investitorët që investojnë në zonat më pak të zhvilluara të Kosovës, duke përfshirë projekte të targetuara infrastrukturore dhe subvencionimin e të punësuarve përmes fondit të punësimit.



Shtylla 6: Sektor Dinamik dhe i Qëndrueshëm Bujqësor

Fuqizimi i bujqësisë si një komponent kyç i ekonomisë së Kosovës përmes investimeve në teknologji, infrastrukturë dhe programe për mbështetjen e fermerëve.

Zotimi 1: KONSOLIDIMI I TOKËS PËR RRRITJE

- Krijimi i një tregu të rregullt të tokës bujqësore në Kosovë, duke përmirësuar bazën ligjore për shitblerje dhe qiradhënie.

Zotimi 2: ZGJERIMI I SUBVENCIONEVE BUJQËSORE

- Zgjerimi i skemave të subvencioneve dhe granteve, të shoqëruara me masa për lehtësira në qasjen në kredi më të favorshme, për të siguruar më shumë burime financiare për fermerët që duan të investojnë në teknologji të avancuar. Fermerët do të kenë mbështetjen financiare që u nevojitet për të përmirësuar produktivitetin dhe për të konkurruar në tregjet vendore dhe ndërkombëtare.

Zotimi 3: MBËSHTETJA E KAPACITETEVE PËRPUNUESE

- Shërbime të këshillimit për zhvillimin e biznesit, realizimin e kërkimeve të tregut, si dhe mbështetje financiare për investime në teknologji dhe pajisje të avancuara për prodhim.

Zotimi 4: PROGRAME PËR ARRITJEN E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE

- Fuqizimi i Institutit Bujqësor në bashkëpunim edhe me qendrat tjera shkencore universitare për të

përbushur standardet e cilësisë dhe për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme për të fituar akreditim ndërkombëtar.

Zotimi 5: MASA MBROJTËSE DHE PRODUKTE SIGURIMI PËR FERMERËT

■ Përkrahje në ndërtimin e sistemeve që bazohen në masa parandaluese, përfshirë edhe pajisje teknologjike, për tu mbrojtur nga dëmet klimatike.

■ Qasje në produkte të sigurimit bujqësor me mbulueshmëri të gjerë dhe me kosto të përballueshme dhe të mbështetur nga shteti.



Qëllimi 2

Jetë më e mirë për secilin



PDK

Ne synojmë ta bëjmë Kosovën një vend tërheqës për të jetuar, për të punuar dhe për të ndërtuar një të ardhme prosperuese. Kosova do të shndërrohet në një vend të mirë për rritjen e një familjeje. Të rinjtë do të gjejnë perspektivën e nevojshme për zhvillimin e tyre, familjet do të gjejnë mbështetjen e shtetit në çdo hap, dhe shteti do të garantojë siguri dhe kushte ideale për të gjithë ata që synojnë një jetë të lumtur. Nëpërmjet masave për rritjen e të ardhurave për familjet kosovare dhe ofrimin e shërbimeve publike cilësore, do ta bëjmë Kosovën një vend që ofron jetë më të mirë për të gjithë.



Shtylla 1: Paga, pensione dhe përfitime sociale për një jetesë dinjitoze

Ne synojmë që çdo qytetar të gëzojë një jetë të dinjitetshme, përmes pagave meritore, pensioneve dinjitoze dhe një sistemi gjithëpërfshirës të mbështetjes sociale. Ky synim ngritet mbi parimet e qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes, dhe ofron mbështetje thelbësore për individët në faza të ndryshme të jetës.

Zotimi 1: RITJJA E PAGAVE PËR SEKTORIN PUBLIK

■ Paga do të rritet me 50% për të gjitha kategoritë e sektorit publik, duke përfshirë mësimdhënësit, mjekët, infermierët, punonjësit e administratës dhe të gjitha shërbimet publike. Kjo rritje nuk do të jetë e njëjtë edhe për pozitat që aktualisht kanë paga të larta, përfshirë pozitat me emëri me politike. Rritja për këto kategori do të jetë 30%. Rritja e pagave në sektorin publik do të përmirësojë mirëqenien e punonjësve, nxisë motivimin dhe kontribuojë në një sektor publik më të fuqishëm dhe më të qëndrueshëm.

Zotimi 2: RITJJE E PENSIONEVE PËR TË GJITHA KATEGORITË E PENSIONISTËVE

■ Ne do të rrisim pensionet për të siguruar një jetë të dinjitetshme për pensionistët tanë. Kjo rritje reflekton përkushtimin tonë për të mbështetur ata që kanë kontribuar në shoqërinë tonë, duke u mundësuar atyre të gëzojnë siguri financiare dhe një cilësi më të mirë jetese në vitet e tyre të pensionit. Në qeverisjen tonë:

- Pensioni bazë do të ngritet në 200 euro.
- Pensionet kontributdhënëse do të rriten për 30%.

Zotimi 3: PËRMIRËSIMI I PËRFITIMEVE PËR KATEGORITË E DALA NGA LUFTA

■ PDK nderon sakrificat e mëdha të luftëtarëve tanë të lirisë dhe familjeve të tyre, të cilët me guximin dhe përkushtimin e tyre kanë formësuar shtetin tonë. Ne e njohim kontributin e tyre të paçmuar dhe jemi të angazhuar për t'u siguruar atyre dhe familjeve të tyre mbështetje dhe respektin që meritojnë, si një testament i guximit dhe qëndresës së tyre. Në qeverisjen tonë:

Përfitimet e të gjitha kategorive të luftës, duke përfshirë familjet e dëshmorëve, veteranët dhe invalidët e luftës, do të rriten për 50%.

Prindërit e familjeve të dëshmorëve nuk do të duhet të zgjedhin ndërmjet pensionit të moshës dhe pensionit të familjes së dëshmorit, por do t'i përfitojnë të dy llojet e pensioneve.

Do të heqim kufizimet për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfutues të pensionit të veteranit, që të jenë aktivë në tregun e punës.

Zotimi 4: RITJJA E MBËSHTETJES PËR FAMILJET QË PRANOJNË NDIHMA SOCIALE

■ Përmes reformave dhe rritjes së asistencës financiare, synojmë të përmirësojmë cilësinë e jetesës dhe të krijojmë mundësi për integrim më të plotë ekonomik e social të këtyre familjeve. Në qeverisjen tonë:

Asistenca financiare për familjet që pranojnë ndihma sociale të do rritet për 50%.

Shtylla 2: Pleqëri me dinjitet

Synojmë një shoqëri ku të moshuarit gëzojnë respekt, përkujdesje të denjë dhe mbështetje të plotë nga sistemi ynë social dhe shëndetësor. Duke njohur kontributin e tyre jetësor, ne angazhohemi për politika që rrisin cilësinë e jetës së tyre, lehtësojnë barrën e kujdesit për familjet dhe fuqizojnë solidaritetin social.

Zotimi 1: Shëndet pa shpenzime për të moshuarit: barëra falas për të moshuarit me sëmundje kronike. Ne do të ofrojmë barëra falas për të moshuarit që vuajnë nga sëmundje kronike, duke u siguruar që ata të kenë qasje në trajtimet që u nevojiten pa barrë financiare.

Zotimi 2: Do të krijojmë qendra të specializuara për kujdesin e të moshuarve në secilin region të Kosovës. Këto qendra do të ofrojnë kujdes mjekësor të specializuar, terapi fizike, aktivitete sociale dhe kulturore, si dhe trajnime për aftësitë jetësore që ndihmojnë të moshuarit të ruajnë pavarësinë e tyre. Kjo nismë jo vetëm që vlerëson kontributin e të moshuarve, por edhe mundëson pjesëmarrjen më të madhe të kujdestarëve familjarë, sidomos të grave, në jetën ekonomike dhe shoqërore.





Shtylla 3: Mbështetje për Prindërit dhe Kujdes Cilësor për Fëmijët

Ne synojmë të krijojmë mundësi të barabarta për prindërit dhe mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët. Ky angazhim ndihmon në lehtësimin e barrës për familjet, rrit mundësitë e punësimit për prindërit dhe siguron mjedise cilësore e përkujdesje që mbështesin zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

Zotimi 1: Do të ofrojmë një subvencion prej 100 eurosh në muaj për familjet që nuk mund t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në çerdhet publike dhe që i regjistrojnë ata në çerdhe private, duke siguruar kështu mundësi më të përballueshme dhe të qasshme për kujdesin ndaj fëmijëve. Ky veprim do të lehtësojë drejtpërdrejt barrën financiare për prindërit, do të lehtësojë aktivizimin e grave në tregun e punës, si dhe do të mbështesë zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

Zotimi 2: Me qëllim të ofrimit të kujdesit të nevojshëm dhe më afër shtëpisë për fëmijët me nevoja të veçanta, do të ndërtojmë qendra të qëndrimit ditor falas për këtë kategori të fëmijëve në shtatë qytete të Kosovës. Marrë parasysh nevojat e kushtueshme të kujdesit, përfshirë dietat më të kushtueshme, do të rrisim edhe shtesat që shpërndahen për këto kategori.

Shtylla 4: Investime në Parqe dhe Infrastrukturë Sportive

Hapësirat publike dhe infrastruktura sportive janë qenësore për promovimin e mirëqenies së komunitetit dhe për një cilësi më të mirë jetese. Kjo shtyllë fokusohet në rritjen e hapësirave të gjelbra dhe objekteve sportive në të gjitha qytetet.

Zotimi 1: PARQET URBANE DHE HAPËSIRAT E GJELBRA

■ Mbështetje për çdo komunë për zhvillimin e parqeve të reja urbane dhe peri-urbane, si dhe përmirësimin e hapësirave ekzistuese të gjelbra për të përmirësuar qasjen për të gjithë qytetarët.

Zotimi 2: NDËRTIMI I STADIUMIT KOMBËTAR OLIMPIK TË FUTBOLLIT

■ Ndërtimi i Stadiumit Kombëtar Olimpik është një projekt i rëndësishëm që synon të krijojë një qendër moderne dhe funksionale për futbollin dhe sportet e tjera të atletikës. Ky stadium do të ofrojë një infrastrukturë të avancuar që përfshin një terren futbollit sipas standardeve të FIFA-s dhe UEFA-s.

Zotimi 3: OBJEKTET E MËDHA TË INFRASTRUKTURËS SPORTIVE

■ Rehabilitimi, Modernizimi dhe Revitalizimi i Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

■ Renovimi dhe modernizimi i objekteve të mëdha të infrastrukturës sportive për sportet e brendshme në të gjitha komunat e Kosovës.

■ Mbështetje për çdo komunë me modernizimin dhe transformimin e stadioneve kryesore të futbollit në çdo qytet.



Qëllimi 3

Arsim për të ardhmen



Ne synojmë t'i ofrojmë çdo nxënësi dhe studentin në Kosovë dijen, shkathtësitë dhe mundësitë që u nevojiten për të pasur sukses në një botë që po ndryshon me shpejtësi. Duke e pajisur sistemin arsimor me burimet dhe mbështetjen e nevojshme si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit e studentët, Kosova do të pozicionohet si shembull i transformimit arsimor në rajon.



Shtylla 1: Avancimi i edukimit të hershëm

Ofrimi i arsimit në fëmijërinë e hershme për të gjithë fëmijët është thelbësor për ndërtimin e një themeli të fortë arsimor. Duke zgjeruar qasjen në çerdhe cilësore dhe duke zhvilluar programe bashkëkohore të edukimit të hershëm, ne do t'i japim çdo fëmije mundësinë për të zhvilluar shkathtësitë shoqërore dhe kognitive të nevojshme për mësimin gjithë-jetësor.

Zotimi 1: NDËRTIMI I ÇERDHEVE TË REJA

■ Ndërtimi i kopshteve të reja në të gjitha rajonet për të përmbushur kërkesën në rritje për arsimimin në fëmijërinë e hershme. Prioriteti ynë do të jetë ndërtimi i çerdheve të reja fillimisht në zonat ku aktualisht nuk ekziston asnjë strukturë parashkollore, duke mundësuar qasje më të lehtë për fëmijët dhe familjet që jetojnë në këto zona.

Zotimi 2: TRAJNIMI PËR EDUKATORËT E FËMIJËRISË SË HERSHME

■ Zhvillimi i programeve të trajnimit për edukatorët e fëmijërisë së hershme për të ofruar kujdes dhe arsimim cilësor në të gjitha çerdhet në Kosovë. Pajisja e çerdheve me mjete didaktike të nevojshme si dhe harmonizimi i kurrikulave me standardet ndërkombëtare.

Shtylla 2: Mësimdhënës dhe Profesorë të së Ardhmes

Për t'i përgatitur nxënësit për të ardhmen, ne kemi nevojë për mësues që janë të pajisur me dijen dhe shkathtësitë e duhura. Duke aftësuar edukatorët me njohuri mbi teknologjinë dhe duke investuar në zhvillimin e tyre të vazhdueshëm, Kosova do të nxisë dhe mbështesë një sistem arsimor i cili jo vetëm që plotëson standardet e sotme, por është gjithashtu i përgatitur për sfidat e së nesërme.

Zotimi 1: PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL PËR MËSIMDHËNËS

- Do të krijojmë Qendrën Kombëtare për Trajnim të Vazhdueshme për Mësimdhënësit, e cila do të ofrojë programe të avancuara për zhvillimin profesional të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, të fokusuara në didaktikë, teknologji edukative dhe metodologji të reja të mësimdhënies.

Zotimi 2: ZHVILLIMI I TREGUESVE TË PERFORMANCËS PËR MËSIMDHËNËSIT

- Me qëllim të krijimit të një sistemi transparent dhe të përgjegjshëm në arsim, do të zhvillojmë tregues të qartë për matjen e performancës së mësimdhënësve.



Shtylla 3: Digjitalizimi i Arsimit Fillor dhe të Mesëm

Shfrytëzimi i teknologjisë për të përmirësuar arsimimin dhe për tu siguruar që asnjë nxënës të mos mbetet prapa në epokën digjitale është thelbësor. Duke ofruar mjete digjitale dhe duke krijuar një platformë kombëtare digjitale të mësimin, Kosova do të transformojë sistemin e saj arsimor, duke e bërë mësimin të qashtë për të gjithë, pavarësisht vendndodhjes apo prejardhjes socio-ekonomike.

Zotimi 1: TABELAT DHE MJETET TJERA DIGJITALE

- Instalimi i tabelave digjitale dhe mjeteve të tjera digjitale në të gjitha klasat për të përmirësuar mësimin interaktiv.

Zotimi 2: SOFTUERI DIGJITAL KOMBËTAR PËR ARSIMIN

- Zhvillimi i një infrastrukture qendrore digjitale me një aplikacion të platformës kombëtare që lidh studentët, mësuesit, prindërit dhe politikëbërësit. Kjo platformë do të shërbejë që komunikimi në mes të akterëve arsimorë të jetë i lehtë dhe i shpejtë.

Zotimi 3: AVANCIMI I KURRIKULËS DHE PËRFSHIRJA E MATERIALEVE MËSIMORE DIGJITALE

- Do të miratojmë dhe zbatojmë ligjin për tekstet shkollore, duke siguruar që tekstet të jenë të përputhura me kurrikulën dhe të përfshijnë materiale digjitale për të përmirësuar cilësinë e arsimit.

- Tekstet shkollore digjitale do të jenë interaktive dhe lehtësisht të përditësueshme, duke lejuar një përvojë të të mësuarit dinamik që ndjek standardet globale arsimore.

Shtylla 4: Arsim cilësor, shkolla të sigurta dhe të shëndetshme

Kalimi në një sistem shkollor gjithëditor si dhe ofrimi i aktiviteteve jashtëshkollore do t'u ofrojë nxënësve mbështetje gjithëpërfshirëse gjatë gjithë ditës. Përveç kësaj, përmes rishqyrtimit, kurrikulat dhe tekstet shkollore do të jenë në përputhje me sfidat e sotme në arsim. Ofrimi i sigurisë së nxënësve është me rëndësi parësore, veçanërisht duke pasur parasysh nivelet gjithnjë në rritje të dhunës, bullizmit dhe abuzimit.

Zotimi 1: PROGRAMET KUNDËR BULLIZMIT

■ Zbatimi i programeve kundër bullizmit bazuar në praktikat më të mira të BE-së, duke përfshirë trajnime për mësuesit dhe fushata ndërgjegjësimi për bullizmin, si online ashtu edhe në mjedise fizike.

Zotimi 2: PSIKOLOGË DHE ZYRTARË TË SIGURISË NË ÇDO SHKOLLË

■ Ofrimi i shërbimeve mbështetëse të shëndetit mendor në shkolla për të ndihmuar nxënësit të përballen me bullizmin dhe abuzimin, ku çdo shkollë në Kosovë do të ketë një psikolog. Caktimi i zyrtarëve të trajnuar të sigurisë në shkollat fillore dhe të mesme për të parandaluar dhe trajtuar dhunën.

Zotimi 3: AKTIVITETE MËSIMORE JASHTËSHKOLLORE DHE MËSIM GJITHËDITOR

■ Ofrimi i aktiviteteve mësimore pas shkollës, përfshirë sportin, artin dhe mentorimin, për të mbështetur zhvillimin e studentëve në partneritet me sektorin privat. Inicimi i programeve shkollore gjithëditore në shkolla të përzgjedhura për të rritur produktivitetin.

Zotimi 4: RISHQYRTIMI I KURRIKULAVE KOMBËTARE DHE TEKSTEVE SHKOLLORE

■ Fillimi i rishikimit të kurrikulave kombëtare dhe teksteve shkollore aktuale, për të qenë në përputhje me të ardhmen në arsim. Ne do të përshpejtojmë miratimin dhe zbatimin e ligjit për tekstet shkollore, duke siguruar që tekstet të jenë të përputhura me kurrikulën dhe të përfshijnë materiale digjitale për të përmirësuar cilësinë e arsimit. Kjo do të përfshijë dispozita për tekstet shkollore digjitale me një skemë pune, përkthimin dhe përshtatjen e teksteve të huaja, dhe zhvillimin e një pakete edukative.



Shtylla 5: Arsimi i lartë i harmonizuar me nevojat e tregut

Arsimi i lartë i harmonizuar me nevojat e tregut është jetik për përgatitjen e studentëve për karriera domethënëse dhe ndërtimin e një ekonomie konkurruese. Kjo qasje do të ndihmojë në krijimin e një fuqie punëtore të aftë, të adaptueshme dhe të gatshme për të kontribuar në zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror të Kosovës.

Zotimi 1: PARTNERITETET UNIVERSITET-INDUSTRI DHE PROGRAME DUALE TË STUDIMIT

■ Zhvillimi i partneriteteve ndërmjet universiteteve dhe industrive kryesore për të harmonizuar kurrikulat me kërkesat e tregut të punës. Kjo përfshin praktikën, programet e bashkëpunimit dhe kurset e udhëhequra nga industria që pajisin studentët me shkathtësitë praktike të nevojshme për punësimin e ardhshëm.

Zotimi 2: REFORMAT E KURRIKULËS TË SHTYERA NGA TREGU

■ Reformimi i kurrikulave universitare për të pasqyruar më mirë nevojat e ekonomisë, përfshirë programe të fokusuara në teknologjinë e informacionit, inxhinierinë dhe sektorë të tjerë me staf deficitar. Ne do të punojmë për të siguruar që programet universitare të dizajnohen dhe të përditësohen vazhdimisht bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe përparësitë strategjike të shtetit.

Zotimi 3: STIMUJT PËR KËRKIM DHE INOVACION

■ Ofrimi i granteve dhe stimujve për

projekte kërkimore që fokusohen në zgjidhjen e sfidave kryesore ekonomike në Kosovë, duke inkurajuar inovacionin dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet akademisë dhe sektorit privat. Qendra për kërkim dhe zhvillim do të krijojë një kornizë për të përcaktuar nivelin e duhur të kërkimit për Kosovën, bazuar në potencialin e saj në njohuri, financa dhe zhvillim industrial.

Zotimi 4: FONDI SHETËTOR I BURSAVE

■ Fondi Shtetëror i Bursave do të ofrojë bursa për studentët që ndjekin diploma në fusha që janë kritike për ekonominë e ardhshme të Kosovës.



Qëllimi 4

Sistem shëndetësor me pacientin në qendër



PDK

Krijimi i një sistemi shëndetësor që ofron kujdes të qashtëm dhe modern për të gjithë qytetarët është thelbësor për përmirësimin e cilësisë së jetesës. Ky sistem do të sigurojë shërbime mjekësore të lehta për t'u arritur, të fokusuar në nevojat e pacientëve, duke kontribuar kështu në një shoqëri më të shëndetshme.

Shtylla 1: Ndërtimi i Sistemit të Sigurimit Shëndetësor

Ne angazhohemi për të krijuar një sistem sigurimi shëndetësor të qëndrueshëm dhe efikas, duke funksionalizuar legjislacionin dhe zbatuar sigurimet shëndetësore për të garantuar financimin e kujdesit mjekësor. Përmes dixhitalizimit, do të ndërtojmë një platformë të integruar që lidh të gjitha nivelet e shërbimeve shëndetësore, duke siguruar kujdes të koordinuar dhe cilësor për çdo qytetar.

Zotimi 1: FUNKSIONALIZIMI I SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE.

■ Do të plotësohet dhe përmirësohet legjislacioni primar dhe sekondar, për të filluar pastaj me implementimin e sigurimeve shëndetësore. Implementimi i sigurimeve shëndetësore do të krijojë qëndrueshmëri financiare për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, ndërsa investimet qeveritare do të fokusohen në infrastrukturën shëndetësore, pajisje mjekësore, edukim të vazhdueshëm profesional dhe përmirësim të kushteve të punës për profesionistët shëndetësorë, për të ofruar kujdes shëndetësor efikas dhe kualitativ për të gjithë qytetarët.

Zotimi 2: DIGJITALIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR

■ Do të krijojmë një platformë digjitale, tërësisht të integruar dhe efikase, e cila do të lidhë të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve. Ky sistem do të sigurojë që pacientët të marrin kujdes të koordinuar dhe të vazhdueshëm, nga vizitat ambulantore deri te trajtimi në spitale të specializuara. Strategjia e përgjithshme për digjitalizimin e sistemit shëndetësor synon modernizimin e këtij sistemi, duke përmirësuar cilësinë e kujdesit, efikasitetin e shërbimeve dhe qasjen për të gjithë qytetarët. Kjo do të ndihmojë në ndërtimin e një sistemi shëndetësor të qëndrueshëm dhe të sigurt, që përmbush nevojat e tërë popullsisë.

Shtylla 2: Shërbime shëndetësore cilësore afër qytetarit

Ne jemi të angazhuar për të ndërtuar një sistem shëndetësor të fortë dhe efikas. Përmes investimeve në infrastrukturë, pajisje moderne dhe trajnime për stafin mjekësor, synojmë të ofrojmë shërbime shëndetësore të nivelit të lartë afër qytetarëve, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës në Kosovë.



Zotimi 1: FUQIZIMI I SPITALEVE RAJONALE

■ Do të përqendrohemi në investimin në infrastrukturën dhe pajisjet e spitaleve rajonale për të garantuar që këto institucione të ofrojnë shërbime të nivelit të lartë. Do të krijojmë një plan për të angazhuar përkohësisht mjekë të specializuar nga ShSKUK në spitalet rajonale. Me këtë synojmë të rrisim cilësinë e shërbimeve, të përmirësojmë bashkëpunimin dhe trajnimet për mjekët, të reduktojmë listat e pritjes dhe të shfrytëzojmë më mirë kapacitetet ekzistuese në spitalet rajonale.

Zotimi 2: NDËRTIMI I SISTEMIT KOMBËTAR TË EMERGJENCEVE MJEKËSORE

■ Sistemi Kombëtar i Emergjencave Mjekësore ka për qëllim të krijojë një rrjet të koordinuar dhe efikas për trajtimin e situatave emergjente mjekësore në të gjithë Kosovën.


Zotimi 3: NDËRTIMI I SPITALIT RAJONAL TË PRISHTINËS

■ Ndërtimi i Spitalit Rajonal të Prishtinës është një hap jetik për përmirësimin e sistemit shëndetësor në rajon, pasi do të eliminojë një boshllëk të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve shëndetësore sekondare.

Zotimi 4: RRRITJA E NIVELIT TË PËRGJITHSHËM TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE

■ Ne do të analizojmë rastet që referohen jashtë vendit dhe do të investojmë në pajisje moderne dhe trajnime për stafin. Kjo do të ndihmojë në ofrimin e shërbimeve bashkëkohore brenda vendit. Do të nënshkruajmë

memorandume bashkëpunimi me vende si Gjermania, Italia dhe Turqia për të sjellë ekspertë ndërkombëtarë në Kosovë për periudha gjashtëmuore deri në njëvjeçare. Ky hap do të ndihmojë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe në trajnimin e stafit vendor.



Shtylla 3: Kujdes i avancuar shëndetësor për njerëzit e prekur nga sëmundjet kronike dhe varësitë

Ne synojmë të krijojmë një sistem të integruar dhe gjithëpërfshirës të kujdesit shëndetësor në Kosovë, që ofron shërbime të specializuara për pacientët me sëmundje kronike, varësi dhe çrregullime neuro-zhvillimore. Me një qasje multidisiplinare dhe mbështetje psiko-sociale, ne përmirësojmë cilësinë e jetës për individët dhe familjet e tyre, duke promovuar rehabilitimin, integrimin social dhe respektin për dinjitetin e çdo personi.

Zotimi 1: PROGRAMI I KUJDESIT PALIATIV

■ Ky program synon të krijojë një rrjet të integruar të shërbimeve për pacientët me sëmundje kronike dhe të pashërueshme, duke ofruar kujdes fizik, emocional dhe psikologjik për pacientët dhe familjet e tyre. Qendrat e kujdesit paliativ do të krijohen në rajone të ndryshme të Kosovës dhe do të ofrojnë shërbime mjekësore të specializuara, trajtim të dhimbjes dhe mbështetje të personalizuar për pacientët në fazat e fundit të sëmundjeve. Përveç kujdesit në qendrat e specializuara, programi do të ofrojë kujdes paliativ në shtëpi.

Zotimi 2: QENDRA KOMBËTARE PËR TRAJTIMIN E VARËSIVE

■ Kjo qendër do të jetë një institucion i specializuar për trajtimin e varësive nga substancat narkotike, alkooli dhe lojërat e fatit, duke ofruar shërbime të plota rehabilitimi dhe reinteprimi për të prekurit. Qendra do të shërbejë si një pikë qendrore për trajtimin dhe

mbështetjen terapeutike, duke ndihmuar pacientët të përballen me varësinë dhe të rikthehen në jetën e tyre të përditshme me mbështetje psiko-sociale.

Zotimi 3: PROGRAMI KOMBËTAR PËR KUJDESIN NDAJ AUTIZMIT DHE SËMUNDJEVE NEURO-ZHVILLIMORE

■ Qendrat e specializuara për autizëm do të ofrojnë terapi të sjelljes, terapi të folurit dhe shërbime edukative të personalizuara për fëmijët dhe të rriturit me autizëm. Ky program synon gjithashtu të mbështesë familjet duke u ofruar udhëzime praktike dhe grupe mbështetëse, që do t'i ndihmojnë në menaxhimin e sfidave të përditshme që lidhen me autizmin. Përmes këtij programi, individët me autizëm do të kenë mundësi të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të integrohen më mirë në shoqëri, ndërsa familjet do të marrin mbështetjen e nevojshme për t'i ndihmuar në këtë rrugëtim.




Qëllimi 5

Një Kosovë e sigurt dhe e integruar



PDK

Rruga e Kosovës drejt stabilitetit, rritjes dhe prosperitetit mbështetet në një strategji gjithëpërfshirëse që ngërthen sigurinë, angazhimin diplomatik dhe integrimin ekonomik. Kjo kërkon një qasje të shumanshme, me theks të veçantë në bashkëpunim, gjithëpërfshirjen dhe partneritetet strategjike për të siguruar një të ardhme të sigurt dhe të begatë për qytetarët e Kosovës.



Shtylla 1: Siguri për çdo qytetar

Do të forcohet siguria e brendshme dhe e jashtme e Kosovës për të mbrojtur sovranitetin e saj dhe për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët.

Zotimi 1: PËRMIRËSIMI I MBROJTJES KOMBËTARE

■ Modernizimi i infrastrukturës mbrojtëse të Kosovës, me fokus rritjen e kapaciteteve mbrojtëse për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme. Përmirësimi i infrastrukturës ushtarake, përmirësimi i sistemeve të inteligjencës dhe investimi në operacionalizimin e Gardës Kombëtare për të forcuar gatishmërinë e mbrojtjes dhe për të integruar angazhimin civil në përpjekjet e sigurisë kombëtare. Siguria mjedisore gjithashtu do të mishërohet në strategjitë e mbrojtjes.

Zotimi 2: MASAT KUNDËR TERRORIZMIT DHE TË SIGURISË KIBERNETIKE

■ Zbatimi i kornizave të avancuara të inteligjencës për t'iu mbrojtur nga kërcënimet kibernetike dhe fushatat e dezinformimit. Duke integruar teknologjitë më të fundit dhe duke miratuar marrëveshje për shkëmbimin e inteligjencës me partnerët rajonalë dhe globalë, forcohet aftësia për të luftuar terrorizmin dhe aftësi rezistuese ndaj sfidave të reja të sigurisë.

Zotimi 3: POLICIMI NË KOMUNITET

■ Afirmimi i besimit ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe komuniteteve lokale nëpërmjet strategjive policore gjithëpërfshirëse dhe me bazë në

komunitet. Duke rritur në mënyrë strategjike numrin e policisë, duke rritur trajnimin e oficerëve dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve dhe organeve të zbatimit të ligjit, adresohen shqetësimet e sigurisë lokale në mënyrë më efektive, duke përmirësuar kështu sigurinë publike dhe duke reduktuar krimin.

Zotimi 4: KRIJIMI I GARDËS KOMBËTARE

■ Ngritja e Gardës Kombëtare në një forcë tërësisht operacionale, si pjesë e një strategjie më të gjerë për modernizimin e forcave mbrojtëse të Kosovës. Pajisja e Gardës me personel, trajnim dhe resurset e nevojshme për t'u siguruar që ajo të përmbushë në mënyrë efektive rolin e saj në sigurinë kombëtare dhe reagimin ndaj fatkeqësive, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Garda do të ofrojë kapacitete të reagueshme të shpejtë, do të rrisë përpjekjet për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe do të angazhojë civilët në sigurinë kombëtare, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe partneritetet strategjike të mbrojtjes.



Shtylla 2: Dialogu

Vazhdimi i dialogut konstruktiv të ndërmjetësuar nga BE-ja me Serbinë për të zgjidhur kontestet e pazgjidhura dhe për të promovuar paqen dhe integrimin rajonal. Fokusi është në arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme, me njohjen reciproke në qendër.

Zotimi 1: ANGAZHIMI KONSTRUKTIV NË DIALOG

■ Angazhimi në negociata konsistente dhe konstruktive, lehtësuar nga ndërmjetësuesit e BE-së dhe SHBA-së, për të adresuar çështjet qenësore si njohja reciproke dhe të drejtat e komuniteteve jo-shumicë.

Zotimi 2: NXITJA E DIALOGUT TË BRENDSHËM ME SERBËT E KOSOVËS

■ Angazhim në dialog konsistent dhe konstruktiv me komunitetin serb në Kosovë për të siguruar integrimin e plotë dhe respektimin e të drejtave të tyre.

Zotimi 3: PROJEKTET E INTEGRIMIT EKONOMIK DHE ZHVILLIMIT TË KOMUNITETIT SERB NË KOSOVË

■ Hulumtimi i projekteve ekonomike për të ngritur besimin dhe mirëqenien ekonomike, duke i hapur rrugë integrimit të plotë në shoqërinë kosovare. Fushat e fokusit mund të jenë projekte në infrastrukturë, ndërmarrësi, si dhe arsim e shëndetësi.

Shtylla 3: Integrimi në NATO

Arritja e integrimit të plotë në NATO për të lidhur një partneritet afatgjatë të mbrojtjes dhe për të rritur stabilitetin rajonal.

Zotimi 1: REFORMAT E MBROJTJES

■ Sigurimi i modernizimit të vazhdueshëm të FSK-së, me fokus në kapacitete që janë në përputhje me NATO-n, përfshirë mbrojtjen kibernetike, logjistikën dhe gatishmërinë operacionale. Intensifikimi i pjesëmarrjes në stërvitjet dhe simulimet ushtarake të NATO-s, duke dëshmuar më tej angazhimin tonë ndaj ndërveprueshmërisë.

Zotimi 2: PARTNERITETI PËR PAQE (PPF)

■ Fuqizimi i bashkëpunimit përmes nismave aktuale të udhëhequra nga NATO, duke lobuar njëkohësisht, në mënyrë aktive, për përfshirjen formale në programin e Partneritetit për Paqe. Dëshmimi i mëtejshëm i përkushtimit ndaj stabilitetit rajonal përmes ushtrimeve bashkëpunuese dhe iniciativave të sigurisë për të forcuar argumentin për anëtarësim të plotë.

Shtylla 4: Integrimi në BE dhe organizata ndërkombëtare

Përsheptimi i integritimit në Bashkimin Evropian, duke siguruar përfitime ekonomike dhe politike nëpërmjet anëtarësimit.

Zotimi 1: SIGURIMI I STATUSIT TË KANDIDATIT

■ Finalizimi i procesit të aplikimit për statusin e kandidatit. Punë me institucionet e BE-së si dhe me shtetet anëtare për t'u siguruar që Kosova të bëhet zyrtarisht një vend kandidat.

Zotimi 2: ANËTARËSIMI NË KOMBET E BASHKUARA

■ Vazhdimi i përpjekjeve për të siguruar anëtarësimin në OKB, duke punuar përmes kanaleve diplomatike për të siguruar njohje dhe mbështetje më të gjerë. Shfrytëzimi i përparimit në fusha të tjera, posaçërisht në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja, për të siguruar anëtarësim në agjencitë e OKB-së.

Zotimi 3: PËRMBYLLJA E ANËTARËSIMIT NË KËSHILLIN E EVROPËS

■ Punë me partnerët për të finalizuar anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

Zotimi 4: REFORMAT EKONOMIKE

■ Miratimi i rregulloreve dhe praktikave ekonomike të standardeve të BE-së, duke u përqendruar në fusha siç janë: lehtësimi i tregtisë, zhvillimi i qëndrueshëm dhe transformimi digjital. Shfrytëzimi i fondeve të para-anëtarësimit dhe të Planit të Rritjes të BE-së për të zbatuar reformat e nevojshme.

Zotimi 5: FORCIMI I SHTETIT LIGJOR

■ Përmirësimi i pavarësisë së gjyqësorit, luftimi i korrupsionit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut për t'u harmonizuar me kriteret e BE-së për anëtarësim.



Kosova mundet ma mirë!

Bedri Hamza
për Kryeministër.

PDK